



REPUBLIKA E SHqipërisë
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 19/11/2024
Nr. 3288

**FTESË PËR NEGOCIATË
PËR
AGJENCITË E SPECIALIZUARA/ORGANET E MEDIAVE VIZIVE PËR PRODHIM
E VIDEOVE/SPOTE EDUKUESE, INFORMUESE DHE NDËRGJEGJËSUESE, NË
KUADËR TË ZGJEDHJEVE PËR KUVEND 2025.**

Në zbatim të urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër) nr. 376, datë 15.11.2024, “Prodhimin e spoteve në kuadër të edukimit, informimit, ndërgjegjësimit të zgjedhësve, Faza I” për zgjedhjet për Kuvend 2025, vendimit nr.1195, datë 05.08.2008 të Këshillit të Ministrave “Për blerjen, zhvillimin prodhimin e bashkëprodhimin e programeve ose reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat, për kolë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore” dhe VKM nr. 689, datë 06.11.2024 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2024 miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të realizojë “Prodhimin e spoteve” në kuadër të edukimit, informimit, ndërgjegjësimit të zgjedhësve, Faza I” për zgjedhjet për Kuvend 2025.

Objekti: “Prodhimi i spoteve në kuadër të edukimit, informimit, ndërgjegjësimit të zgjedhësve, Faza I” për zgjedhjet për Kuvend 2025.

Periudha e realizimit: Realizimi i shërbimeve do të jetë 10 ditë nga data e dorëzimit të kërkesave të KQZ sipas objektit së kërkuar.



Fondi limit: fondi limit i procedurës është në vlerën *është 2,833,333.33 (dy milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.*

Kohëzgjatja e kontratës: deri më 31.12.2024

Publikimi i ftesës për negociata:

Afati përfundimtar për paraqitjen e dokumentacionit nga agjencitë e specializuara është më datë 25.11.2024

Konfirmimet për vazhdimin e negociatave: Konfirmimet duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në zarf jotransparent, në një ditë të vetme, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e subjektit dhe me shënimin: Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm komisioni i vlerësimit të ofertave dhe jo përpara datës 25 Nëntor 2024 ora 16:00. Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura. Jeni të lutur të paraqiteni pranë Autoritetit tonë kontraktor:

Emri: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Nr.4

Gjuha për hartimin e ofertave është: Shqip

Në emër të Komisionit për ndjekjen e procedurave me objekt "Prodhimi i videove (spote) në kuadër të edukimit, informimit, ndërgjegjësimit të zgjedhësve, Faza I" për zgjedhjet për Kuvend 2025", kriteret do të jenë si më poshtë:

Qëllimi: Prodhimi i spote audiovizive edukuese me metrazh të shkurtër dhe të mesëm në funksion të informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, të cilat do të shpërndahen në televizionet dhe radiot, me qëllimin mirëinformimin dhe sensibilizimin për procesin zgjedhor si faze e parë kërkimi i emrit në listën e zgjedhësve dhe krimet zgjedhore.

Përshkrimi:

Prodhimin i spoteve për tv dhe radio, në kuadër të informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvend 2025.

Spotet dhe imazhet informuese, duhet të përmbajnë në fokus informacion të plotë dhe të detajuar për procesin zgjedhor 2025.

Spotet duhet të realizohen në përputhje me standardet dhe teknikat më të avancuara të filmimeve dhe duhet të jenë të përshtatshëm për formatin e transmetimit Full HD.

I. SHËRBIMET QË KËRKOHEN TË REALIZOHEN:

Prodhimi i spoteve duhet të jetë në format për transmetim televiziv dhe radio. Spotet duhet të kenë përmbajtjen e qëllimit të vendosur në këtë ftesë për negociatë, sipas kërkesës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke përfshirë të gjitha kategoritë e zgjedhësve.

Karakteristikat:

- Gjatësia mesatarisht 35 - 50 sekonda;
- Cilësia full HD;
- Kualiteti 4K;
- Voice Over Profesional;
- Spotet informuese duhet të jenë gjithsej 4 (katër), shoqëruar nga një seri imazhesh statike me mesazh zgjedhor;
- Spot tv informues për të gjithë zgjedhësit për të kontrolluar emrin në listen e zgjedhësve, nëse kanë parregullsi se ku duhet të drejtohen;
- Spot tv informues për zgjedhësit PAK për të kontrolluar emrin në listen e zgjedhësve, nëse kanë parregullsi se ku duhet të drejtohen;
- Spot tv informues për të gjithë zgjedhësit për parandalimin e krimeve zgjedhore;
- Spot tv informues për zgjedhësit PAK për parandalimin e krimeve zgjedhore;
- Spot radio informues për të gjithë zgjedhësit për të kontrolluar emrin në listen e zgjedhësve, nëse kanë parregullsi se ku duhet të drejtohen
- Spot radio informues për të gjithë zgjedhësit për parandalimin e krimeve zgjedhore;
- Të gjitha spotet tv duhet të jenë të përshtatura në gjuhën e shenjave dhe me titrat në shqip;
- Të gjitha spotet duhet të përshtaten me titra në gjuhën e 8(tetë) minoriteteve që jetojnë në Shqipëri.

Për realizimin e spoteve të mësipërme kërkohet paraprakisht:

Operatori ekonomik duhet të realizojë shërbimet e përcaktuara më lart në funksion të objektit "Prodhimi i spote në kuadër të edukimit, informimit, ndërgjegjësimit të zgjedhësve, Faza I" për zgjedhjet për Kuvend 2025.

Operatori duhet të dorëzojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, materialet e përgatitura në CD në format të editueshëm dhe në rrugë elektronike.

Spotet duhet të realizohen në përputhje me standardet dhe teknikat më të avancuara të filmimeve me kualitet 4K dhe Full HD.



Spotet duhet të përmbajnë sloganin kryesor, logon zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të gjitha mjetet e komunikimit elektronik zyrtarë të KQZ.

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e spotit.

Materialet e spotit TV duhet të dorëzohen në Formatin HD.

Materialet e përshtatura për transmetim duhet të dorëzohen në format VIDEO HD1080, Format MP4 kopje në DVD/USB.

2. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

1. është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
2. nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
3. nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
4. personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
5. nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
6. nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
7. nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
8. ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
9. kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Shënim: Për plotësimin e kërkesave të mësipërme mund ti paraqesim më vetdeklarim dhe përpara fazës së shpalljes së fituesit përfundimtar, shoqëria e renditur e para më pikë do të sjellë dokumentacionin provues.

III. KRITERET E VECANTA TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit për negociata, kontrata të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit të parashikuar për këtë shërbim. Kjo do të vërtetohet me dokumentet e mëposhtme:
 - *Për kontrata me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
 - *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
2. Ofeta ekonomike: Operatorët do të duhen të paraqesin ofertën ekonomike të detajuar sipas 5 zërave të shërbimit të paraqitur më sipër në vlerën pa tvsh.
3. Operatorët ekonomik do të paraqesin një projekt ide/ zgjidhje teknike/ propozim për realizmin e shërbime që kërkohen.

A- KRITERET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i ofertës ekonomike është më të favorshme sipas pikëzimit të mëposhtëm:

- **Kriteret e përgjithshme: 20**
- **Kapacitet teknik dhe profesional 30**
- **Oferta financiare e shoqëruar me Projekt propozimin për realizmin e kontratës 50**

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në lekë, pa TVSH.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave, përfaqësuesit apo personat me autorizim.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Protokollit, përpara orës së përcaktuar.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet përtej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Kjo ftesë për negociata do të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën: www.kqz.gov.al



Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri |



| info@kqz.gov.al | kqz.gov.al | +355 4 4510810